



Pranimi / Dostizanje Prisipeno / Pristalo Received / Dohizety		07-04-2021		1	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Jedinstvo Org. / Unit	Nr. Prot. No. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix		Sasia Kolicina Quantity	
BRVNSHCK	1647/2021			114	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.104/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.104/2021 të datës 25.02.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: fshati Vitomiricë, Rajoni 3, Komuna e Pejës , kundër Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Pejës të datës 03.01.2020 me Nr.01-118/02-0002213/20, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 07.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. **REFUZOHET si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.104/2021 e datës 25.02.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 23.02.2021 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila më datë 25.02.2021 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe është regjistruar më nr. Prot:830/2021, me pretendimet ankimore se me rastin e pensionimit i kanë takuar edhe 2 (dy) paga të tjera në formë kompensimi sipas Kontratës Kolektive dhe legjislacionit në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.03.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Pejës. Më datë 19.03.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Pejës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit ë parashtruar në Këshillin e Pavarur të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës e datës 25.02.2021 më numër protokolli:830/2021; Vendimin e Menaxheri të Personelit të Komunës së Pejës të datës 18.02.2021 me Nr.02-400/01-15563; Aktvendimin e Kryetarit të Komunës së Pejës të datës 03.01.2020 me Nr.01-118/02-0002213/20 për pensionimin e ankuesit; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.03.2021 me numër protokolli:928/2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 03.03.2021 me numër Nr.928/2021 e protokolluar në KPMSHCK me numr:17274/2021 të datës 19.03.2021; Kopjen e fletë dorëzimit të shkresës të datës 22.02.2021; Ndryshimi dhe plotësimin e Akt Emërimit të ankuesit të datës 27.02.2013; Njoftimin për pensionim e ankuesit të datës 17.10.2019; Aktvendimin e Kryetarit të Komunës së Pejës të datës 03.01.2020 me Nr.01-118/02-0002213/20 për pagesën e kompensimit të ankuesit në vlerën e një page me rastin e pensionimit; Listën e pagës së ankuesit për muajin shkurt të vitit 2020 nga Buxheti i Republikës së Kosovës me Kodin:10-65095-630610; Listën e Transferit me shifër nr. 10-65095-6353610 të datës 25.02.2020 të vlerës së një pagë (492.94€) së bashku me listën e bashkangjitur të pagës së kompensimit për ankuesin; emailin e datës 29.03.2021 me korrespondencën e bashkangjitur, kërkesën e ankuesit të parashtruar në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës të datës 12.02.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi si dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesi në bazë të Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 27.02.2013 ka qenë i punësuar në pozitën “Shef i Shërbimit Juridiko-Administrativ pranë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi” në Komunën e Pejës. Në bazë të Aktvendimit me numër Nr.01-118/02-0002213/20 të datës 03.01.2020 të Kryetarit të Komunës së Pejës ankuesit i është përfunduar marrëdhënia e punës me rastin e arritjes së moshës së pensionimit me datë 29.02.2020. Po ashtu, Kryetari i Komunës së Pejës ka nxjerrë Aktvendimin e datës 03.01.2020 duke i njohur të drejtën e një page përcjellëse me rastin e pensionimit së ankuesit.

Ankuesi i pa kënaqur me shumën e kompensuar, ka parashtruar kërkesë në Njësinë e Burime Njerëzore të Komunës së Pejës me datë 12.02.2021. Ndërsa, Menaxheri i Personelit i komunës së Pejës me datë 18.02.2021 ka nxjerrë Vendimin me numër: 02-400/01-15563 më të cilën janë shpallur jo kompetentë dhe në pajtim me neni 75 të Ligjit Nr.06/L-031 të Procedurë së Përgjithshme Administrative palën e kanë udhëzuar se organ kompetent për zgjidhjen e kërkesës së tij është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimi të shkresave të lëndës, ka Konstatuar se ankuesi siç e ka potencuar edhe në ankesën e parashtruar në Këshill, me datën 29.02.2020 e ka arritur moshën e pensionimit 65 (gjashtëdhjetepesë) vjeç dhe është pensionuar, njëherë edhe i ka përfunduar marrëdhënia e punës në shërbimin civil, siç është e përcaktuar edhe me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 90 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 i cili përcakton se: “*Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon me arritjen e moshës së pensionimit*”, dhe neni 91 paragrafi 1 i të njëjtit ligj i cili përcakton se: “*Mosha e pensionimit e nëpunësve civilë, si të gjinisë mashkullore ashtu edhe të asaj femërore, është gjashtëdhjetepesë (65) vjeç*”.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimi të shkresave të lëndës, ka konstatuar se në bazë të Listës së Transferit me shifër nr. 10-65095-6353610 të datës 25.02.2020 ankuesit i është bërë kompensimi me rastin pensionimit në vlerën e një page prej (492.94€), siç e përcaktojnë dispozitat e nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: *“Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit”. Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit”.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 50 paragrafi 1, dhe nenin 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020 si dhe nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, vlerëson se çdo nëpunës civil ka të drejtën të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, me të cilin pretendon se i janë cenuar të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës në Shërbimit Civil.

Po ashtu, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 127 paragrafi 1, ka përcaktuar se: *“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”,* si dhe neni 75 paragrafi 4 i të njëjtit ligj përcakton se: *“Në rast të kërkesave të parashtruara gabimisht, siç parashihet me paragrafin 1 të nenit 75 të këtij Ligji, afati kundrejt parashtruesit do të vlerësohet si i respektuar nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit (në kohe) pranë organit publik jo kompetent, ndërsa afati përkatës kundrejt organit publik kompetent do të fillojë të përllogaritet tri (3) ditë pas parashtrimit të kërkesës pranë organit jo kompetent”,* andaj nga kjo rrjedh se fillimisht ankuesi me rastin e parashtrimit të kërkesës së datës 12.02.2021 në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës e pastaj sipas udhëzimit me rastin e parashtrimit të ankesës së datës 25.02.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 127 paragrafit 1, pasi që palës afati 30 (tridhjetë) ditor ka filluar t’i rrjedh prej momentit që e ka pranuar Aktvendimin e Kryetarit të Komunës së Pejës me numër Nr.01-118/02-0002213/20 të datës 03.01.2020 me të cilin ankuesit i njihet e drejta e kompensimit në vlerën e një page me rastin e pensionimit, dhe prej asaj kohe ka kaluar pothuajse 1(një) vit dhe në bazë të provave të sjellë në ankesë pala s’ka ndërmarr asnjë hap tjetër procedural dhe si e tillë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill është refuzuar si e pabazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.104/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

